



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 483/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.10.2020 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

Objekt: Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Blueprint Technologies” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozime”, me nr. REF-70561-09-02-2020, me objekt: “Shërbim Printim Fatura Debitorë”, me fond limit 903,000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 15.09.2020, nga autoriteti kontraktor Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a.

Ankimues: “Blueprint Technologies” sh.p.k.
Rruga “Fortuzi”, Nr.66/1, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a.
Adresa: Rruga “Rruga e Kavajës, Ndërtesa nr.133, Njësia
Administrative 6, Kodi Postar 1027, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 03.09.2020, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Kërkesë për propozime”, me nr. REF-70561-09-02-2020, me objekt: “Shërbim Printim Fatura Debitore”, me fond limit 903,000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 15.09.2020, nga autoriteti kontraktor Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a.

II.2. Në datën 15.09.2020, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, autoriteti kontraktor në datë 18.09.2020 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | |
|-------------------------------------|----------------------------|
| 1. “Blueprint Technologies” sh.p.k. | 516.000 lekë, skualifikuar |
| 2. “F.L.E.SH” sh.p.k. | 640.700 lekë, skualifikuar |
| 3. “TE Electronics” sh.p.k. | 675.960 lekë, skualifikuar |
| 4. “Inpress” sh.p.k. | 752.500 lekë, kualifikuar |
| 5. “Adel Co” sh.p.k. | 872.900 lekë, kualifikuar |

II.4. Në datën 18.09.2020 operatori ekonomik “Blueprint Technologies” sh.p.k., është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me arsyetimin si më poshtë:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky operator ekonomik, nga ku konkludon si më poshtë vijon: Së pari AK ka kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit si më poshtë vijon: Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tre viteve të fundit,(nga data e zhvillimit të tenderit) me një vlerë sa 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet ose 361, 200(treqind e gjashtëdhjetë e një mijë e dyqind)lekë pa tvsh. - Kur shërbimi i mëparshëm i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore,Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e plotë dhe të suksesshëm të kësaj kontrate. - Kur shërbimi i mëparshëm i ngjashëm është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat përkatëse tatimore ku të jetë shënuar datat,shuma,shërbimi i realizuar të nënshkruar nga të dyja palët. Në përmbushje të kushtit të kërkuar më lart operatori ekonomik ka paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike faturë tatimore nr.4722, datë 12.02.2020 me palë blerëse Movida Trade me vlerë 180,000(njëqind e tetëdhjetë)mijë lekë pa tvsh. Gjithashtu gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike KVO vëren se operatori ekonomik ka paraqitur vërtetim realizimi të lëshuar nga Ujësjiellës Kanalizime Elbasan datë 06.02.2020 nr.prot 169 me vlerë 276,480(dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e tetëdhjetë)lekë me tvsh. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se operatori ekonomik duhej të paraqiste kontratën e nënshkruar me AK Ujësjiellës Kanalizime Elbasan sh.a shoqëruar me vërtetimin e realizimit ose meqënëse se lloji i procedurës është “blerje e vogël” në mungesë të mosnënshkrimit të kontratës me institucionin operatori ekonomik duhej të paraqiste faturën tatimore të lëshuar nga institucioni. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim. Pra, fatura e paraqitur si shërbim i ngjashëm nga operatori ekonomik “Blue Print Technologies” me vlerë 180,000(njëqind e tetëdhjetë mijë)lekë me palë “Movida Trade” nuk përmbush vlerën e kontratës të ngjashme të kërkuar nga AK. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit dhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për

Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

II.5. Në datën 22.09.2020 operatori ekonomik “Blueprint Technologies” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike, me arsyetimin si më poshtë vijon:

[...] Të nderuar anëtarë të komisionit të shqyrtimit të ankesës operatori ekonomik “Blueprint Technologies” sh.p.k., ka marrë pjesë në procedurën e mësipërme. Më datë 18.09.2020 nëpërmjet SPE kemi marrë njoftimin për renditjen e operatorëve ekonomikë dhe skualifikimin e operatorit ekonomik “Blueprint Technologies” sh.p.k., me argumentimin si më poshtë vijon:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky operator ekonomik, nga ku konkludon si më poshtë vijon: Së pari AK ka kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit si më poshtë vijon: Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tre viteve të fundit, (nga data e zhvillimit të tenderit) me një vlerë sa 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet ose 361, 200(treqind e gjashtëdhjetë e një mijë e dyqind) lekë pa tvsh. - Kur shërbimi i mëparshëm i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e plotë dhe të suksesshëm të kësaj kontrate. - Kur shërbimi i mëparshëm i ngjashëm është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat përkatëse tatimore ku të jetë shënuar datat, shuma, shërbimi i realizuar të nënshkruar nga të dyja palët. Në përmbushje të kushtit të kërkuar më lart operatori ekonomik ka paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike faturë tatimore nr.4722, datë 12.02.2020 me palë blerëse Movida Trade me vlerë 180,000(njëqind e tetëdhjetë)mijë lekë pa tvsh. Gjithashtu gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike KVO vëren se operatori ekonomik ka paraqitur vërtetim realizimi të lëshuar nga Ujësjellës Kanalizime Elbasan datë 06.02.2020 nr.prot 169 me vlerë 276,480(dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e tetëdhjetë)lekë me tvsh. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se operatori ekonomik duhej të paraqiste kontratën e nënshkruar me AK Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a shoqëruar me vërtetimin e realizimit ose meqënëse se lloji i procedurës është “blerje e vogël” në mungesë të mosnënshkrimit të kontratës me institucionin operatori ekonomik duhej të paraqiste faturën tatimore të lëshuar nga institucioni. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim. Pra, fatura e paraqitur si shërbim i ngjashëm nga operatori ekonomik “Blue Print Technologies” me vlerë 180,000(njëqind e tetëdhjetë mijë)lekë me palë “Movida Trade” nuk përmbush vlerën e kontratës të ngjashme të kërkuar nga AK. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet

dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit dhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Pra oe “Blueprint Technologies” sh.p.k., është skualifikuar sepse nuk ka paraqitur faturën e shërbimit kundrejt Autoritetit Kontraktor sha Ujësjellës Kanalizime Elbasan.

Kundështojmë skualifikimin me argumentat si më poshtë:

1. Për furnizimin e shërbimit kundrejt sha Ujësjellës Kanalizime Elbasan oe ka paraqitur vërtetim realizimi pasi duke qënë blerje e vogël në shumicën e rasteve nuk hartohet kontratë.
2. Në asnjë kërkesë në DST nuk kërkohet që OE të paraqei faturën e shërbimit kundrejt një enti publik sha Ujësjellës Kanalizime Elbasan. Nëse do ta kishte kërkuar nuk kemi asnjë arsye të mos ta paraqisnim, pasi përsa kohë furnizimi i shërbimit është kryer me sukses, patjetër që është lëshuar dhe fatura tatimore përkatëse pasi nuk ka asnjë mundësi që një ent publik të lëshojë një vërtetim për një shërbim që është marrë dhe për të cilin nuk është lëshuar faturë tatimore. Përsa kohë që kërkesa për të paraqitur faturën tatimore nuk ka qënë në DST rrjedhimisht nuk duhet të skualifikohet oe për mungesën e një dokumenti të pakërkuar.
3. Qëllimi i kërimit të dokumentacionit mbi punët e ngjashme është që AK-ja të krijojë besimin që oe ka realizuar punë të ngjashme në të shkuaën e si rrjedhim proporcionalisht mund të realizojë shërbimin në fjalë. Pra kërkesa për dokumenta nuk duhet të shifet si qëllim në vetvete, përsa kohë që dokumenti alternativë është paraqitur plotëson më së miri kërkesën që oe të tregojë që ka realizuar me sukses një shërbim printimi në të shkuarën.
4. Në VKM-në 914 datë 29.12.2014 i ndryshuar neni 27 parashikon Referojmë nenin 27[...]. Pra AK-ja kërkon si dëshmi vërtetime nga enti publik (cka është paraqitur nga OE) ose/dhe fatura tatimore të shitjes. Pra ose fatura ose vërtetime. Nuk parashkohet fare që të paraqitet si dëshmi kontratë e ngjashme. Dhe përsa kohë që nuk është kërkuar specifikisht fatura e shitjes skualifikimi është i pambështetur në ligj.

OE ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar/nevojshëm që ka qënë në dispozicion të tij të mbështetur në LPP dhe VKM me të cilin ka vërtetuar furnizimet e ngjashme. Përsa m'ësipër kërkojmë nga KSHA-ja të pranojë ankesën e “Blueprint Technologies” sh.p.k. duke rivlerësuar procedurën dhe kualifikuar oe duke qënë dhe oferta me cmimin më të ulët. [.....]

II.6. Referuar dokumentacionit bashkëlidhur ankesës së operatorit ekonomik ankimues si dhe informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, ky i fundit më anë të shkresën nr.k-2480/1 prot, datë 28.09.2020, i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik “Blueprint Technologies” sh.p.k., duke e refuzuar atë.

II.7. Në datën 05.10.2020 operatori ekonomik “Blueprint Technologies” sh.p.k., ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. K-2749/1prot., datë 14.10.2020, protokolluar me tonën në datën 16.10.2020, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me argumentin se “Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky operator ekonomik, nga ku konkludon si më poshtë vijon: Së pari AK ka kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit si më poshtë vijon: Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tre viteve të fundit, (nga data e zhvillimit të tenderit) me një vlerë sa 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet ose 361, 200(treqind e gjashtëdhjetë e një mijë e dyqind) lekë pa tvsh. - Kur shërbimi i mëparshëm i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e plotë dhe të suksesshëm të kësaj kontrate. - Kur shërbimi i mëparshëm i ngjashëm është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat përkatëse tatimore ku të jetë shënuar datat, shuma, shërbimi i realizuar të nënshkruar nga të dyja palët. Në përmbushje të kushtit të kërkuar më lart operatori ekonomik ka paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike faturë tatimore nr.4722, datë 12.02.2020 me palë blerëse Movida Trade me vlerë 180,000(njëqind e tetëdhjetë)mijë lekë pa tvsh. Gjithashtu gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike KVO vëren se operatori ekonomik ka paraqitur vërtetim realizimi të lëshuar nga Ujësjellës Kanalizime Elbasan datë 06.02.2020 nr.prot 169 me vlerë 276,480(dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e tetëdhjetë)lekë me tvsh. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se operatori ekonomik duhej të paraqiste kontratën e nënshkruar me AK Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a shoqëruar me vërtetimin e realizimit ose meqënëse se lloji i procedurës është “blerje e vogël” në mungesë të mosnënshkrimit të kontratës me institucionin operatori ekonomik duhej të paraqiste faturën tatimore të lëshuar nga institucioni. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta,

konsiderohen si kushte për skualifikim. Pra, fatura e paraqitur si shërbim i ngjashëm nga operatori ekonomik “Blue Print Technologies” me vlerë 180,000(njëqind e tetëdhjetë mijë)lekë me palë “Movida Trade” nuk përmbush vlerën e kontratës të ngjashme të kërkuar nga AK. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit dhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1.Në Shtojcën 8 të dokumentave të tenderit të procedurës objekt shqyrtimi, pika 2.3. e “Kapacitetit teknik”, nga autoriteti kontraktor është kërkuar si më poshtë:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tre viteve të fundit,(nga data e zhvillimit të tenderit) me një vlerë sa 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet ose 361, 200(treqind e gjashtëdhjetë e një mijë e dyqind)lekë pa tvsh.

- Kur shërbimi i mëparshëm i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore,Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e plotë dhe të suksesshëm të kësaj kontrate.

- Kur shërbimi i mëparshëm i ngjashëm është realizuar me subjekte private,Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat përkatëse tatimore ku të jetë shënuar datat,shuma,shërbimi i realizuar të nënshkruar nga të dyja palët.

III.1.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik ankimues “Blueprint Technologies” sh.p.k., ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

1. Faturë tatimore shitje “Movida Trade” sh.p.k nr. 4722 datë 12.02.2020 me vlerë 180.000lekë pa tvsh, Përshkrimi i mallit ose shërbimit Printime A4.
2. Vërtetim realizimi me Nr. 169Prot datë 06.02.2020, lëshuar nga SHA Ujësjellës Kanalizime Elbasan.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

III.1.4. Në nenin 28 pika 3 “Kontratat e Shërbimeve”, pika 3 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon: Dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe faturave tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

III.1.5. Nisur nga sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimues nuk ka dorëzuar dokumentacion sipas kërkesave të autoritetit kontraktor të përcaktuara në dokumentat e tenderit, pasi ka paraqitur vetëm një faturë tatimore me një subjekt privat dhe një vërtetim realizimi lëshuar nga autoriteti kontraktor përkatës konkretisht sha Ujësjellës Kanalizime Elbasan me qëllim justifikimin e realizimit me sukses të kontratës objekt prokurimi. Në rregullat e prokurimit publik përcaktohet se autoriteti kontraktor për dëshmitë për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, duke e lënë në të drejtën e tij për të përcaktuar nëse do të kërkojë vërtetime ose fatura apo vërtetime dhe fatura. Në rastin konkret autoriteti kontraktor në zbatim të bazës ligjore të sipërcituar për kontrata të mëparshme të realizuara me sektorin publik, ka përcaktuar kriterin duke kërkuar kontrata të mëparshme të shoqëruara detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror për realizimin e plotë dhe të suksesshëm të kësaj kontrate. Ky kriter nuk është plotësuar nga operatori ekonomik ankimues, pasi prej tij është paraqitur vetëm një faturë tatimore shitje e realizuar me subjekt privat dhe një vërtetim realizimi lëshuar nga sha Ujësjellës Kanalizime Elbasan, por asnjë kontratë apo faturë tatimore e lidhur/nënshkruar mes tij dhe sha Ujësjellës Kanalizime Elbasan, referuar aktit ligjor në rastin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël konkretisht në pikën 19 të Udhëzimit nr.3, datë 08.01.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar parashikohet se “[...] *Pagesa për prokurimet me vlerë të vogël bëhet sipas legjislacionit tatimor në fuqi. Në çdo rast, faturat e mallrave apo të shërbimeve duhet të jenë të rregullta sipas legjislacionit në fuqi, si dhe të nënshkruhen nga anëtarët e komisionit. Faturat e lëshuara kanë vlerën e kontratës së lidhur, kur palët nuk kanë*

nënshkruar një të tillë.[...]”. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, përbën kusht për skualifikimin e tij. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik “Blueprint Technologies” sh.p.k. referuar dokumentacionit të paraqitur nuk vërteton se përmbush kapacitetin në lidhje me punët e mëparshme të ngjashme, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Blueprint Technologies” sh.p.k., për procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozime”, me nr. REF-70561-09-02-2020, me objekt: “Shërbim Printim Fatura Debitore”, me fond limit 903,000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 15.09.2020, nga autoriteti kontraktor Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Nr. 1224;Protokolli

Datë 05.10.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri